



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 727 Akti**

**Nr. 783 Vendimi**  
**Tiranë, më 12.7.2024**

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr.1 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                            |           |
|----------------------------|-----------|
| <b>Pamela Qirko</b>        | Kryesuese |
| <b>Valbona Sanxhaktari</b> | Relatore  |
| <b>Alma Faskaj</b>         | Anëtare   |

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Mevi Dibra, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, në datën 8.7.2024, ora 11:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), në Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Anida Bica**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Znj. Anida Bica i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 1 të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, si dhe pikës 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të funksionit të saj si ndihmëse/këshilltare ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit prej datës 5.6.2015.

Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2021, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, me përbërje si më sipër në këtë vendim.

**2.** Me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, është vendosur kryesuese komisionere Pamela Qirko, është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe ka nisur hetimi administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

**3.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit është njoftuar mbi përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

**4.** Nga relatorja e çështjes, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë administruar, raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Gjatë hetimit administrativ është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike, ku i janë dërguar pyetëtori i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera në vijim të hetimit administrativ, të cilat u administruan në dosje.

**5.** Trupi gjykues, i mbledhur në datën 14.6.2024, ora 11:00, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes e, në vijim, pas diskutimeve, me vendimin nr. 2, vendosi: (a) përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Anida Bica, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera, thirrjen e dëshmitarit, afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta; (ç) të paraqesë parashtrimet e saj lidhur me rezultatet e hetimit.

**6.** Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e administruara në dosjen e hetimit, duke marrë një kopje të saj. Në vijim, brenda afatit të caktuar nga Komisioni, paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me rezultatet e hetimit.

**7.** Më tej, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, datë 3.7.2024, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Anida Bica për t’u paraqitur në seancë dëgjimore në datën 8.7.2024, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0.

**8.** Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 8.7.2024, ora 11:00, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

**9.** Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në këtë seancë dëgjimore publike. Gjatë kësaj seance dëgjimore, subjekti parashtroi qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë.

**10.** Trupi gjykues, për shkaqe objektive që lidhen me vendimmarrjen e tij, me vendimin nr. 4, datë 9.7.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, vendosi të shtyjë seancën e shpalljes së vendimit për në datën 12.7.2024, ora 09:45.

**11.** Trupi gjykues përfundoi procesin e rivlerësimit për znj. Anida Bica në seancën e datës 12.7.2024, seancë në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

## **II. PROCESI I RIVLERËSIMIT**

**12.** Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.

84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

**13.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjektipranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqëruar;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja, së bashku me materialin shoqëruar;
- ç) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik dhe shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin provues të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përfundim të hetimit kryesisht;
- dh) denoncimet nga publiku.

**14.** Lidhur me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit Anida Bica, trupi gjykues vëren se ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, duke komunikuar me Komisionin në mënyrë korrekte dhe brenda afateve të përcaktuara gjatë procedurës së hetimit administrativ.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**15.** Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

**16.** Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 86/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**17.** Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**18.** Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Anida Bica iu nënshtrua një hetimi administrativ të plotë e të thelluar nga Komisioni.

<sup>1</sup> 41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

19. Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

### **Lidhur me vlerësimin e pasurisë**

**20. Automjet “Smart Coupe”,** viti i prodhimit 2004, targë AA \*\*\* NX, blerë me të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

**20.1** Komisioni hetoi mbi këtë pasuri dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja<sup>2</sup>, si dhe informacioni i dërguar në kuadër të pyetësorëve<sup>3</sup>, nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se:

**20.2** Automjeti me targë AA \*\*\* NX është blerë nga subjekti i rivlerësimit me Kontratë Shitjeje Automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.10.2016, në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, nga shtetasja F.M. Kjo e fundit e ka blerë automjetin me Kontratë Shitjeje Automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.5.2016, në vlerën 2.325 (dy mijë e treqind e njëzet e pesë) euro (314.503 lekë).

**20.3** Automjeti është shitur në datën 28.1.2019 nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet Kontratës së Shitblerjes së Automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., në vlerën 2.000 (dy mijë) euro, vlerë kjo më e lartë sesa e blerjes së tij në vitin 2016, pasi subjekti përpara blerjes ka kryer riparimin e automjetit<sup>4</sup> në vlerën 66.000 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

**20.4** Nga verifikimi i regjistrimit elektronik të sistemit të AMF-së subjekti i rivlerësimit ka qenë mbajtës i policës së sigurimit TPL për periudhën 11.7.2017 – 4.10.2019.

**20.5** Rezultati i analizës financiare të kryer nga Komisioni mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit e nxjerr këtë të fundit me mundësi financiare.

**20.6** Trupi gjykues çmon se lidhur me këtë pasuri përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, duke mos konstatuar problematika në kuadër të procesit të rivlerësimit.

**21. Llogari rrjedhëse në vlerën 30.846,62 (tridhjetë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë e gjashtëdhjetë e dy te qindtat) lekë** pranë Raiffeisen Bank, në emër të znj. Anida Bica, me pjesë takuese 100%.

**21.1** Raiffeisen Bank<sup>5</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka çelur llogari pranë kësaj banke, llogari e cila ka qenë aktive në periudhën 30.6.2015 – 31.12.2016, në të cilën është kredituar paga. Gjendja e llogarisë në datën e deklarimit (24.1.2017) është në vlerën 35.846,62 lekë. Nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë bankare rezulton se ka një pasaktësi të vogël midis vlerës së deklaruar si gjendje në deklaratën *Vetting* dhe gjendjes së llogarisë në datën e deklarimit, por kjo pasaktësi nuk konsiderohet me rëndësi për procesin e rivlerësimit.

**21.2** Trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri

**22. Automjet tip “Volkswagen”, Golf IV,** viti i prodhimit 2001, targë aktuale AA \*\*\* TJ dhe targë e mëparshme TR \*\*\* N, blerë nga bashkëshorti S.B me të ardhurat nga paga e tij, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë dhe pjesë takuese 100%.

**22.1** DPSHTRR-ja informon<sup>6</sup> se automjeti me targë aktuale AA \*\*\* TJ ka mbajtur më parë targën TR \*\*\* N. Ai është blerë nëpërmjet Kontratës së Shitjes së Automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.3.2008, nga bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit prej shtetases R.M në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Shtetasja R.M e ka blerë automjetin nga shtetasi L.S (përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi A.V), me Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.8.2007, në vlerën 440.000 (katërqind e dyzet mijë) lekë.

<sup>2</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2024 dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj.

<sup>3</sup> Shihni pyetësorin standard dhe atë të datës 29.5.2024.

<sup>4</sup> Shihni “Dublikatë faturë tatimore shitjeje”, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të datës 29.5.2024.

<sup>5</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2024, dosja e hetimit.

<sup>6</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2024 dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj.

**22.2** Automjeti është importuar nga Kosova, me shtet origjine Italinë, nga ana e shtetasit L.S, në datën 27.8.2007. Vlera sipas Deklaratës Doganore është 440.000 (katërqind e dyzet mijë) lekë dhe taksa doganore e paguar është 200.206 (dyqind mijë e dyqind e gjashtë) lekë. Kontrata e shitblerjes midis shtetasve R.M dhe L.S (përfaqësuar me prokurë) është realizuar disa ditë përpara datës së importimit të automjetit dhe me një vlerë më të ulët se vlera e plotë e shpenzimeve prej 640.206 (gjashtëqind e dyzet mijë e dyqind e gjashtë) lekësh (440.000 lekë vlera e mjetit + 200.206 lekë taksa doganore).

**22.3** Dokumentacioni i këtij automjeti fillimisht është bllokuar me urdhër administrativ nr. \*\*\*, datë 28.1.2014, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (ndalim i tjetërsimit, transferim në rreth tjetër, etj.), pasi “... ka dalë jo i rregullt nga verifikimi në sistemin ASF2 të Interpolit”, dhe më pas është sekuestruar në cilësinë e provës materiale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në datën 24.11.2015.

**22.4** Në këto rrethana, Komisioni kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës<sup>7</sup>, si dhe iu drejtua subjektit të rivlerësimit për shpjegime, nga ku rezultoi se:

**22.5** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, në lidhje me automjetin tip “Volkswagen Golf-1J”, nr. shasie \*\*\*, në pronësi të shtetasit S.B, me vendimin e datës 12.3.2015 ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorike”, pas dërgimit të akteve nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të vendimit datë 27.3.2015 nëpërmjet të cilit është vendosur: “Shpallja e moskompetencës tokësore për procedimin penal nr. \*\*\* të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës”. Në datën 11.5.2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur pranë gjykatës kompetente kërkesën për pushimin e këtij procedimi, të regjistruar pa autor të dyshuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës lidhur me këtë kërkesë ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 18.6.2018, nëpërmjet të cilit ka vendosur: “...Pushimin e çështjes penale të procedimit nr. \*\*\*, viti 2015, për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a/1 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë, pasi është parashkruar”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 3.7.2018.

**22.6** Komisioni konstatoi se rrethanat dhe faktet e parashtruara në përgjigjet<sup>8</sup> dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje përputheshin me informacionin e përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

**22.7** Në lidhje me konstatimin e Komisionit se automjeti është bllokuar sërish në datën 10.12.2018 (procesverbal mbi bllokimin e mjetit me targë AA \*\*\* TJ dhe lënien në ruajtje në Komisaratin e Policisë nr. \*\*\*), edhe pse vendimi nr. \*\*\*, datë 18.6.2018, i Gjykatës ka marrë formë të prerë në datën 3.7.2018, në shpjegimet e saj subjekti i rivlerësimit sqaron se: “...kjo situatë ka ardhur për mospasqyrim të të dhënave në sistem nga ana e Policisë dhe Prokurorisë së Rrethit Kukës, pasi çështja penale, procedimi nr. \*\*\*, viti 2015, nuk ekziston tashmë dhe nuk ka asnjë pasojë juridike”. “...konkludohet se janë mosveprimet e pasqyrimit të plotë dhe përcjelljes së vendimmarrjeve përkatëse në autoritetet kompetente, që kanë sjellë bllokimin e automjetit më 19.12.2018, bllokim ky i hequr sipas procesverbalit të datës 25.10.2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”.

**22.8** Nga verifikimi i regjistrimit elektronik të sistemit të AMF-së rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është mbajtës i policës së sigurimit TPL nga data 9.9.2008 deri në datën 26.12.2024.

**22.9** Nga analiza financiare rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. S.B, ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, si dhe për përballimin e shpenzimeve të tjera.

<sup>7</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2024.

<sup>8</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit datë 29.5.2024.

**22.10** Trupi gjykues lidhur me këtë pasuri çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ përputhen e, si rrjedhim, nuk konstatohen problematika në kuadër të procesit të rivlerësimit.

**23. Apartament me sip. 63 m<sup>2</sup>**, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*”, pallati “\*\*\*”, Njësia bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, sipas Kontratës së Porosisë me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë 9.4.2008 me palë: S.B (porositës) dhe B.C, në vlerën 37.800 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) euro dhe pjesë takuese 100%.

**23.1** Nga hetimi i Komisionit mbi këtë pasuri, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit rezultoi sa më poshtë.

**23.2** Z. S.B, në cilësinë e porositësit dhe z. B.C, si përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. (me administrator M.B), kanë lidhur Kontratë Porosie me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë 9.4.2008, ku kanë rënë dakord që investitori të ndërtojë për llogari të porositësit një apartament me sip. 63 m<sup>2</sup>, në godinën e banimit “6 kate me nënçati dhe bodrum” me adresën \*\*\*, ish-\*\*\*. Vlera e apartamentit sipas kontratës është 37.800 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) euro dhe është likuiduar e plotë në dorë nga shtetasi S.B.

**23.3** Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* referon në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., datë 18.6.2005, nëpërmjet së cilës shtetasi M.B ka shprehur vullnetin për t’i dhënë z. S.B një apartament banimi (i përbërë prej dy dhomash e një kuzhinë e ambiente ndihmëse) në ndërtimin që do të ngrejë në truallin e shtetasit M.G, në \*\*\*, Tiranë, dhe se “...e përfiton këtë përqindje në këmbim të ndërmjetësimit të bërë nga ana e tij dhe pronarit të truallit për ndërtimin e një objekti shumëkatësh...”.

**23.4** Komisioni hetoi mbi këtë pasuri, përfshirë edhe mospërputhjet që u konstatuan për të tek të dhënat e Deklaratës *Vetting* me dokumentacionin shoqërues, për sa i takon vendndodhjes, vlerës, mënyrës së përfitimit të saj nga z. S.B, si dhe lidhjen e këtij përfitimi me funksionin që ai kryente pranë ish-Komunës \*\*\*.

**23.4.1** Gjatë hetimeve, si dhe në përgjigjet e pyetësorit të dërguar nga Komisioni<sup>9</sup>, subjekti ka sqaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie është Deklarata Noteriale nr. \*\*\* rep., datë 18.6.2005, por për shkak se dhënia e apartamentit në këmbim të shërbimit të ndërmjetësimit nuk është realizuar në ndërtimin e përcaktuar në deklaratë, ai është përfituar në një ndërtim të së njëjtës shoqëri ndërtimore, por me tjetër vendndodhje. Lidhja e Kontratës së Porosisë me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë 9.4.2008 dhe përcaktimi në të i vlerës prej 37.800 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) euro, edhe pse nuk është paguar, sipas subjektit të rivlerësimit, është bërë për të garantuar që z. S.B të përfitonte apartamentin e premtuar sipas deklaratës noteriale. Subjekti sqaron gjithashtu se vlera është vendosur për shkak se kontrata e porosisë kërkon përcaktimin e një çmimi për apartamentin që të jetë në përputhje me formën e kërkuar nga ligji, si dhe që të mundësohet regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

**23.4.2** Në harkun kohor (prill 2003 – dhjetor 2006) në të cilin z. S.B ka kryer shërbimin e ndërmjetësimit sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., datë 18.6.2005, ai ka qenë i punësuar pranë ish-Komunës \*\*\* në pozicionin *specialist-jurist*, duke mos pasur funksion drejtues apo vendimmarrës në raport me procedurën e lëshimit të lejeve të ndërtimit, sipas legjislacionit të kohës, për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

**23.5** FSHU-ja<sup>10</sup> ka konfirmuar se me gjeneralitetet S.B, në adresën “\*\*\*” \*\*\*, referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet abonent me Kontratë Furnizimi nr. TR\*\*\*, datë 10.6.2010, në instancën Tiranë.

<sup>9</sup> Shihni pyetësorin e datës 29.5.2024 dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, të datës 1.7.2024.

<sup>10</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2024 të Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a.

**23.6** Komisioni i kërkoi ASHK-së informacion nëse godina në të cilën gjendet apartamenti i deklaruar nga z. S.B në deklaratën *Vetting* rezultoi i regjistruar në regjistrin kadastral, por nga ky institucion deri në përfundim të hetimit nuk është dërguar informacion.

**23.7** Kjo pasuri, në datën 11.4.2018, është kaluar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. G.S, nëpërmjet Kontratës së Cedimit të të Drejtave të Kontratës së Porosisë nr. \*\*\* rep., datë 9.4.2008, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, kundrejt shumës 37.800 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) euro.

**23.8** Analiza financiare për apartamentin me sip. 63 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, u krye nga Komisioni, mbi bazën e Kontratës së Porosisë, me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë 9.4.2008, me burim të ardhurat nga paga të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pasi:

a) Nuk u konsiderua si burim krijimi për pasurinë Deklarata Noteriale nr. \*\*\* rep., datë 18.6.2005, sepse vendndodhja, karakteristikat, vlera dhe mënyra e përfitimit të pasurisë në këtë deklaratë nuk përputhet me përmbajtjen e kontratës së porosisë, përmes së cilës është konkretizuar apartamenti, ku subjekti i rivlerësimit ka banuar deri në vitin 2018.

b) Përmes shitjes së apartamentit në vitin 2018 (Kontratë Cedimi të të Drejtave të Kontratës së Porosisë nr. \*\*\* rep., datë 9.4.2008”, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.4.2018) z. S.B i ka kaluar përfituesit të drejtat e fituara sipas Kontratës së Porosisë me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë 9.4.2008, madje edhe në të njëjtën vlerë prej 37.800 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) euro, sa ajo është e përcaktuar në kontratën e porosisë.

**23.9** Në analizën financiare nuk u konsideruan të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për periudhën prill 2007 – mars 2008, të deklaruara si të përfituara nga punësimi pranë “\*\*\*\*” sh.p.k., kjo, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonin të dhënat e deklarimeve tatimore, të domosdoshme në bazë të ligjit nr. 84/2016, duke sjellë si rrjedhim paprovueshmërinë e ligjshmërisë së tyre.

**23.10** Nga analiza financiare ka rezultuar se z. S.B ka qenë në pamundësi financiare, së paku sa vlera e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie, pra -4.656.299 (katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera të kryera deri në këtë periudhë.

**23.11** Në vijim të konstatimit të Komisionit gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe dokumentacionin provues ka ritheksuar qëndrimin e mbajtur në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.5.2024, duke sqaruar se:

a) Pasuria është përfituar nga z. S.B përmes Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., datë 18.6.2005 dhe për të nuk është paguar vlera 37.800 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) euro sipas kontratës së porosisë.

b) Mospërputhja e vendndodhjes, karakteristikave, vlerës dhe mënyrës së përfitimit të pasurisë nga S.B me pasurinë e “premtuar” në këmbim të shërbimit të ndërmjetësimit, vjen si pasojë e mosrespektimit të detyrimit sipas deklaratës noteriale dhe zëvendësimit të saj me një pasuri me tjetër sipërfaqe dhe tjetër adresë.

**23.11.1** Subjekti i rivlerësimit ka nënvizuar gjithashtu se: “... *dua të evidentoj faktin se kjo pasuri është krijuar nga bashkëshorti im shumë përpara se ne të njiheshim apo unë të ushtroja funksionin tim të ndihmëses ligjore. Në këtë mënyrë konstatohet qartësisht se kjo pasuri nuk është e lidhur me funksionin tim si ndihmëse ligjore dhe nuk ka rrjedhur nga ushtrimi i kësaj detyre dhe është jashtë periudhës sime të rivlerësimit*”.

**23.12** Trupi gjykues çmon se lidhur me pamundësinë financiare për krijimin e kësaj pasurie duhet të merret në konsideratë fakti se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, të cilat edhe pse nuk kalojnë testin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi pasuria është krijuar kohë më parë se ata të fillonin jetën bashkëshortore, përpara marrjes së detyrës,

dhe në padijeni të subjektit. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në kuadër të vlerësimit tërësor.

**24. Detyrim nga të tretët në vlerën 950.000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë** sipas Kontratës për Cedim të Drejtave të Kontratës së Porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2015”, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.12.2016, në pjesë takuese 50%. Pasuria garazh, që është objekt i kontratës së cedimit, është blerë sipas Kontratës së Porosisë datë 8.1.2015, në vlerën 950.000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga.

**24.1** Komisioni hetoi lidhur me këtë pasuri të deklaruar dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se:

**24.2** Me Kontratë Porosie Garazh nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës porositëse, ka porositur pasurinë garazh me sip. 30 m<sup>2</sup>, në vlerën 950.000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, tek shtetasi G.N.O (në prani edhe të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*”, sh.p.k.), me vendndodhje në “Godinë banimi 6-katëshe me nënçati e bodrum, në territorin e ish-Komunës \*\*\*”, për të cilën ka likuiduar plotësisht vlerën sipas kontratës.

**24.3** Me Kontratë Cedimi nr. \*\*\*, datë 8.12.2016, bashkëshorti dhe subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e dhënësit të pëlqimit) u kanë kaluar shtetasve G.B dhe M.K pasurinë garazh me sip. 30m<sup>2</sup>, në vlerën 950.000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Nga kjo vlerë është likuiduar në datën 8.12.2016 shuma 300.000 (treqind mijë) lekë, ndërsa vlera e mbetur prej 650.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh është shlyer në dorë, në datën 26.5.2017, sipas Deklaratës Njohje Detyrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.5.2017.

**24.4** Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2015, me burim krijimi të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, nga ku rezultoi se kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e vlerës sipas Kontratës së Porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.1.2015, si dhe për përballimin e shpenzimeve të tjera familjare.

**24.5** Komisioni konstatoi se pasuria garazh është krijuar përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe detyrimi është deklaruar në deklaratën *Vetting* vetëm nga bashkëshorti, por jo nga subjekti i rivlerësimit, duke rezultuar kështu në pasaktësi në deklaram.

**24.6** Lidhur me këtë konstatim të Komisionit subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“...mospasja e informacionit të duhur të Deklaratës Vetting, saktësisht siç më është konstatuar nga ju, citoj se këto pasaktësira kanë ardhur fillimisht për faktin se ky është deklarimi im i parë dhe i vetëm, duke menduar dhe logjikuar se kjo kontratë formalisht është lidhur vetëm nga bashkëshorti im dhe jo nga unë, mendova që pasqyrimi të bëhej vetëm në pjesën e tij, por kjo nuk ka pasur asnjë qëllim në vetvete nga ana ime, e një niveli të tillë që të passjellë marrjen e një mase disiplinore”*.

**24.7 Në përfundim**, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se pasuria është krijuar me burime financiare të mjaftueshme, përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit, dhe se për të nuk kanë rezultuar problematika, vlerëson se pavarësisht pasaktësisë në deklaratën *Vetting*, duke e parë çështjen në harmoni me përmbajtjen e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**25. Kuota në masën 50%, në vlerën 5.000 (pesë mijë) lekë**, në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “\*\*\*\*”, sh.p.k. me numër unik të identifikimit (NIPT) L\*\*\*K. Data e regjistrimit të shoqërisë është 19.8.2015 dhe statusi i saj është *pezulluar* prej datës 10.1.2022.

**25.1** Nga hetimi<sup>11</sup> i Komisionit rezultoi se subjekti tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k. ka ushtruar aktivitet në shërbimin e konsulencës në fushën ligjore, inxhinierike dhe financiare. Ai nuk ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe nuk ka shpërndarë dividend për periudhën 2015 – 2017 nga ky aktivitet tregtar.

<sup>11</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2024, të DPT-së.



**25.2** Për mundësinë e gjendjes së konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit me vetë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe me ortakët e administratorin e saj, nuk rezultuan të dhëna<sup>12</sup>.

**25.3** Trupi gjykues vlerëson se për këtë pasuri deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, duke mos konstatuar problematika në kuadër të procesit të rivlerësimit.

**26. Llogari rrjedhëse për pagën në BKT, në vlerën 10.136,81 (dhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë e tetëdhjetë e një të qindtat) lekë, me pjesë takuese 100%.**

**26.1** BKT-ja<sup>13</sup> ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. S.B, ka çelur llogari page pranë kësaj banke, aktive në periudhën 11.11.2015 – 31.12.2016, në të cilën i është kredituar paga. Gjendja në llogari në datën e Deklaratës *Vetting* (24.1.2017) ka rezultuar në vlerën 10.136,81 (dhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë e tetëdhjetë e një të qindtat) lekë.

**26.2** Trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

**27. Likuiditete (cash) në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, me burim të deklaruar krijimi të ardhurat familjare, pa përcaktuar saktësisht pjesët takuese, por duke përdorur termin “në familje”.**

**27.1** Komisioni konstatoi nga hetimi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën *Vetting*, ndërkohë që bashkëshorti e ka deklaruar atë pa përcaktuar pjesët takuese.

**27.2** Analiza financiare për këtë pasuri u krye nga Komisioni për periudhën (dhjetor 2010 – janar 2017) nga momenti i lidhjes së martesës deri në datën e dorëzimit të Deklaratës *Vetting*<sup>14</sup>, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë qenë në pamundësi financiare në shumën -397.928 (treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) lekë, për krijimin e këtyre kursimeve.

**27.3** Në lidhje me këto gjetje të Komisionit, subjekti i rivlerësimit prapësoi duke shoqëruar edhe me dokumentacion provues, sa vijon:

a) Mbi mosdeklarimin e gjendjes *cash* në Deklaratën *Vetting*: “...duke qenë se pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave janë krijuar nga të ardhurat e bashkëshortit tim dhe meqenëse formalisht Kontrata e Cedimit e vitit 2015 ishte e nënshkruar nga bashkëshorti dhe jo nga unë, mendova që pasqyrimi të bëhet vetëm në pjesën e tij të deklaratës sonë të përbashkët. Tek kolona “Pjesë në %” është përcaktuar “në familje”, duke e konsideruar të pandarë në përqindje kontributin e gjithsecilit. Për sa i përket pjesës takuese në përqindje është deklaruar në familje, pasi nuk ishim në gjendje të përcaktonim pjesën takuese në përqindje konkrete, sa është kontributi i njëri apo i tjetrit”.

b) Mbi pamundësinë financiare për krijimin e gjendjes *cash*

- i. Në analizën financiare Komisioni duhet të konsiderojë të ardhurat nga paga, duke nisur që nga periudha e punësimit si sekretare gjyqësore (shkurt 2007) dhe jo nga data e martesës.
- ii. Në analizën financiare nuk duhet të përfshihet si shpenzim blerja e apartamentit në qytetin e Vlorës me Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011.
- iii. Në analizën financiare të Komisionit duhet të rishikohen shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit për të dhe bashkëshortin gjatë kësaj periudhe<sup>15</sup>, pasi ato janë mbuluar nga të afërmit.

**27.4** Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej saj në cilësinë e provave, në raport edhe me dokumentacionin e administruar

<sup>12</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2024.

<sup>13</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2024, dosja e hetimit.

<sup>14</sup> Në analizë janë konsideruar të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, si dhe mundësia për kursime *cash* duke filluar nga data 24.12.2010, datë në të cilën janë martuar.

<sup>15</sup> Shihni shpjegimet dhe dokumentacionin shoqëruar të subjektit të rivlerësimit të datës 1.7.2024.

gjatë hetimit administrativ, çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti, kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë me burime të ligjshme.

## GJETJE TË TJERA

**28.** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshorti) kanë hequr dorë nga pronësia mbi një apartament (nr. 47), me sip. 42 m<sup>2</sup>, në adresën “\*\*\*”, Vlorë.

**28.1** Komisioni ka konstatuar<sup>16</sup> se me Kontratë Sipërmarrjeje apartament banimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. S.B, ka nënshkruar me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. një kontratë përmes së cilës kanë rënë dakord t’i jepet porositësit apartamenti i banimit nr. 47, me sip. 42 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “\*\*\*”, Vlorë. Vlera e apartamentit sipas nenit 3 të kontratës ka qenë 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, nga të cilat janë likuiduar përpara nënshkrimit të kontratës 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro. Pjesa e mbetur [1.000 (njëmijë) euro] do t’i paguhej shoqërisë ndërtuese në momentin që do të përfundonte ndërtimin dhe do të bëhej dorëzimi i çelësave të apartamentit. Në përmbajtje të këtij neni specifikohet gjithashtu se blerësi deklaroi se të ardhurat për këtë transaksion i burojnë nga kursimet familjare.

**28.2** Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin kanë nënshkruar përpara noteres V.S Deklaratën për Heqje Dorë nga Pronësia nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2017,<sup>17</sup> në favor të shtetasit H.H.B, vjehri i subjektit të rivlerësimit.

**28.3** Nga verifikimi i Deklaratës *Vetting* rezultoi se Kontrata e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011, nuk është deklaruar as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga bashkëshorti. Deklarata noteriale për heqje dorë nga pronësia, në favor të shtetasit H.H.B, është realizuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur pesë ditë (në datën 19.1.2017) përpara datës së dorëzimit të Deklaratës *Vetting* (24.1.2017).

**28.4** Me përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit sqaron se: “...kam nënshkruar për shkak të regjimit martesor Deklaratë Noteriale për kalim pronësie, datë 19.1.2017, të një garsoniere/banesë (blerë nga bashkëshorti me të ardhurat e familjes së tij datë 10.8.2011), në emër të H.B, babait të bashkëshortit tim, duke qenë se ishte blerë me të ardhurat para martesës së bashkëshortit dhe familjes së tij”.

**28.5** Komisioni i kërkoi shpjegime<sup>18</sup> lidhur me gjetjet subjektit të rivlerësimit, i cili sqaroi:

**28.5.1** Mbi arsyet e mosdeklarimit të të drejtave (pasurisë) në Deklaratën *Vetting*: “*Sikundër kam deklaruar në Pyetësorin Standard në vitin 2021, pyetja 20, kjo pasuri është fituar nga ana e bashkëshortit tim në vitin 2011 me të ardhurat e familjes së tij të origjinës. Në atë periudhë unë sapo kisha lidhur martesë me bashkëshortin tim (në datën 24.12.2010) dhe, pavarësisht se sipas Kodit të Familjes ajo nënkuptohej si pasuri e fituar gjatë martesë (e prezumuar <sup>1/2</sup> pjesë takuese secili), në fakt unë nuk kam investuar asnjë të ardhur për blerjen e saj, pasi i gjithë çmimi është paguar nga bashkëshorti im mbi bazën e të ardhurave të familjes së tij të origjinës. Duke qenë se kjo pasuri nuk është blerë në thelb me të ardhurat e bashkëshortit tim pas martesë dhe as prej meje, dhe gjithashtu nuk është poseduar ndonjëherë kjo pasuri, apo të jemi sjellë si pronarë të saj më të gjithë tagrat që përcakton ligji, kemi kryer dhurimin e kësaj pasurie tek vjehri im, babai i bashkëshortit (unë kam firmosur vetëm për shkak të ligjit, duke qenë se kjo pasuri është lidhur gjatë martesës)”.*

**28.5.2** Mbi arsyet e dhurimit/kalimit të të drejtave (pasurisë) tek babai i bashkëshortit 5 ditë përpara dorëzimit të Deklaratës *Vetting*: “... duke qenë se kjo pasuri është krijuar dhe siguruar kryesisht nëpërmjet familjarëve të bashkëshortit, gjykova se meqenëse po i nënshtrohesha këtij procesi, i cili imponon detyrimin e subjektit për të deklaruar marrëdhënien reale juridike,

<sup>16</sup> Shihni aneksin 36, praktika e ILDKPKI-së.

<sup>17</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2024.

<sup>18</sup> Shihni pyetësorin e datës 29.5.2024.

atëherë për të vënë në pah vërtetësinë e kësaj marrëdhënieje, duke qenë se interesin e shprehur për lidhjen e kësaj kontrate dhe barrën më të lartë financiare për pronësinë e apartamentit e ka pasur familja e bashkëshortit tim, gjykuam që këtë fakt ta reflektojmë në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 19.1.2017 (gjithçka e cituar në deklaratë). Qartësoj se kisha vetëm 8 muaj martesë nga momenti i nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes dhe, siç vetëkuptohet, ishte e pamundur të investoja për krijimin e kësaj pasurie. Në atë kohë isha në detyrën e sekretares gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”

**28.5.3** Mbi burimin e të ardhurave të përdorura nga bashkëshorti për krijimin e pasurisë: “...burimi i krijimit të kësaj pasurie është nga Kontratë Shitjeje Pasure nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.4.2009, me vlerë 3.355.000 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, të ardhurat e krijuara nga shitja e shtëpisë të transferuara në llogarinë në lekë, e cila në vijim është pakësuar dhe është tërhequr në shuma të ndryshme dhe depozituar në llogarinë në euro, në vitin 2010. Theksoj se në familjen e tyre, meqenëse ishte fëmija i madh, si fillim të gjitha pasuritë janë vendosur në një llogari të vetme si depozitë kursimi. Pikërisht nëpërmjet kësaj llogarie është paguar edhe vlera e blerjes së garsonierës në Vlorë”.

**28.5.4** Mbi përdorimin ose jo të pasurisë: “...Deklaroj se kjo pasuri është ende në fazë karabinaje dhe nuk ka qenë asnjëherë në përdorim nga askush, sa kohë është i papërdorshëm, i pabanueshëm dhe i pashfrytëzueshëm”.

**28.5.5** Mbi diferencën midis çmimit të blerjes së pasurisë dhe çmimit të referencës: “...Lidhur me çmimin e kontratës, bashkëshorti më ka deklaruar se në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes vlera e kësaj pasurie është thujse e njëjtë me çmimin e referencës së atij viti. Sipërfaqja e përcaktuar në Kontratë është 42 m<sup>2</sup>, ndërkohë që e shfrytëzueshme ka qenë 36 m<sup>2</sup>. Referuar çmimeve të referencës të përcaktuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3/2010, për sipërfaqe të shfrytëzueshme është 59.100 (pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind) lekë/m<sup>2</sup>, llogaritur me 36 m<sup>2</sup>, në total shkon 2.110.000 (dy milionë e njëqind e dhjetë mijë) lekë [ose e konvertuar përafërsisht 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro]...”

**28.5.6** Mbi regjistrimin e pasurisë në regjistrin kadastral: “...Deklaroj se dhe pas 11 vjetësh situata ligjore është po ajo, dhe dëshira e vjehrrit për ta gëzuar jo vetëm që tashmë nuk është, por babai i bashkëshortit nuk e do më atë, duke kërkuar në rrugë gjyqësore “Zgjidhjen e Kontratës së Sipërmarrjes” nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 10.8.2011, me anë të së cilës shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka parashikuar kalimin e pronësisë (detyrimin për t’i dhënë porositësit një apartament banimi nr. 47, me sipërfaqe 42 m<sup>2</sup>, kati i \*\*\* i banimit pranë shkallës së \*\*\*, “\*\*\*”, Vlorë dhe detyrimin e të paditurit, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., t’i kthejë paditësit shumën e shlyer prej tij si detyrim kontraktor në masën 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro”.

**28.6** Komisioni hetoi mbi vlerën e pasurisë referuar vlerës mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë për vitin 2011 për qytetin e Vlorës<sup>19</sup>, nga ku rezultoi se ajo ka qenë [42 m<sup>2</sup> x 60.298 (gjashtëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë/ m<sup>2</sup>] = 2.532.516 (dy milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë rreth 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro sipas kursit të këmbimit për muajin gusht 2011.

**28.7** Nga hetimet e kryera nga Komisioni<sup>20</sup> për mundësinë e gjendjes së konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., si dhe shtetasit R.K si administrator i shoqërisë, nuk rezultuan të dhëna.

**28.8** Nga verifikimi i llogarive bankare rezultoi se z. S.B ka çelur pranë Raiffeisen Bank në datën 4.3.2010 llogari bankare, në të cilën ka depozituar *cash* vlerën 22.000 (njëzet e dy mijë) euro. Në këtë llogari në vijim janë kryer tërheqje dhe depozitime nga z. S.B. Burim krijimi për këtë vlerë është konsideruar shuma 10.000 (dhjetë mijë) euro<sup>21</sup>, e cila rezulton nga

<sup>19</sup> Shihni udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave.

<sup>20</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit.

<sup>21</sup> Në datën 4.3.2010 depozitohen *cash* 22.000 (njëzet e dy mijë) euro me përshkrimin “Derdh në llogari nga shitje shtëpie”. Në total, shuma e depozitimeve të kryera deri në datën 10.8.2011 është 37.100 (tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) euro dhe shuma e tërheqjeve në total 27.100 (njëzet e shtatë mijë e njëqind) euro.

diferenca ndërmjet depozitimeve dhe tërheqjeve të kryera deri në datën e blerjes së pasurisë garsoniere, më 10.8.2011.

**28.9** Analiza financiare u krye nga Komisioni për vitin 2011, vit në të cilin është realizuar Kontrata e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011, dhe burim krijimi janë konsideruar kursimet e subjektit të rivlerësimit e të bashkëshortit nga paga dhe nga pakësimi i likuiditeteve [vlera 22.000 (njëzet e dy mijë) euro, depozituar në bankë në vitin 2010 nga z. S.B]. Nga kjo analizë rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e vlerës 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro sipas Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011, si dhe për përballimin e shpenzimeve të tjera familjare.

**28.10** Nga hetimi, Komisioni konstatoi se:

a) Veprimet juridike për pasurinë objekt i Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011, janë kryer gjatë martesës (data e lidhjes së martesës 24.12.2010), por përpara fillimit të ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

b) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshorti) nuk kanë pasqyruar në Deklaratën Vetting Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011.

c) Subjekti i rivlerësimit, referuar pyetësorit të datës 29.5.2024, dha shpjegime kontradiktore dhe të paprovuara me dokumentacion justifikues për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë.

d) Për Komisionin është krijuar përshtypja se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

**28.11** Lidhur me konstatimet e Komisionit mbi këtë çështje, subjekti i rivlerësimit u qëndroi shpjegimeve të bëra në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.05.2024, dhe shtoi sa vijon:

Arsyeja e realizimit të Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 19.1.2017, për heqje dorë, është pikërisht nga fakti se subjekti nuk ka kontribuar për krijimin e kësaj pasurie: *“...Kam sqaruar në mënyrë të saktë dhe të vërtetë marrëdhënien reale juridike të kësaj kontrate sipërmarrjeje të lidhur shumë pak kohë pas lidhjes sime të martesës, e cila jo vetëm nuk lidhet me ushtrimin tim të detyrës, por as me të ardhurat e krijuara prej meje apo prej bashkëshortit tim. ...pikërisht për të vënë në dukje burimet financiare për krijimin e kësaj pasurie, situatën e vërtetë dhe ligjore, u krye dhe kalimi tek babai i bashkëshortit, i cili realisht është kërkuesi dhe përfituesi real i kësaj pasurie”*.

Nuk ka dhënë shpjegime kontradiktore për krijimin e pasurisë, pasi burim krijimi për të janë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të bashkëshortit në vitin 2009. Subjekti shprehet se: *“...Ritheksoj se kjo pasuri është krijuar nga shitja e apartamentit sipas Kontratës së Shitjes së Pasurisë nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.4.2009, me çmim shitjeje 3.355.000 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë”*.

Nuk gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, pasi shprehet se: *“...kam vepruar ligjërisht bazuar në fakte e prova, vetëm për të qartësuar se burimet financiare për krijimin e kësaj pasurie (datë 11.8.2011 – momenti i nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes) nuk vijnë nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortit tim gjatë martesës (marrëdhënie reale financiare e krijimit të pasurisë). Cilësoj se po të ishim në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, analiza financiare nuk do të ishte në përfundim e tillë, siç edhe ILDKPKI-ja dhe Komisioni kanë konstatuar se ishim në mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. Pra, cila do të ishte arsyeja e mosdeklarimit tim të kësaj pasurie, në kushtet kur referuar edhe analizës së kryer nga ana juaj do të rezultojë me burime të ligjshme për krijimin e saj?”*.

**28.12** Trupi gjykues, në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vëren se: *Në zbatim të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, që referon në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”, subjektet e rivlerësimit duhet të deklarojnë gjendjen e interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve*

financiare që zotërojnë deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit duhet të pasqyrojë në Deklaratën *Vetting* të drejtat reale (Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.8.2011), pasi ajo ka qenë zotëruese e këtyre të drejtave së bashku me bashkëshortin në datën 31.12.2016 dhe nga to ka hequr dorë në datën 19.1.2017.

**28.13 Në përfundim**, trupi gjykues e analizoi këtë pasaktësi në harmoni me dispozitat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, që kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore në kuadër të procesit *Vetting* përpjekje të subjektit për të afektuar vërtetësinë e deklarimeve në Deklaratën *Vetting*. Ky parakusht përjashton pasaktësitë në deklarime si një premisë për shkarkim, përveç rastit kur ato janë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë dhe deklarimin e pasaktë të të dhënave, përfshirë këtu edhe ato lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, të cilat natyrshëm nuk mund të kualifikohen si pasaktësi, por si deklarime të rreme dhe fshehje të pasurisë. Një rrethanë që përforcon bindjen për trupin gjykues, që në këtë rast kemi të bëjmë me një pasaktësi të asaj natyre që nuk mund të konsiderohet shkelje e tillë sa të formojë bazën e duhur ligjore për aplikimin e masës disiplinore, është edhe fakti se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i kanë pasur mundësitë financiare për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

**29.** Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (S.H.B) është përfitues i vendimit nr. \*\*\*, datë 30.12.2021, për legalizim ndërtimi informal (apartament)<sup>22</sup>.

**29.1** Subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi që në Deklaratën *Vetting* dhe në pyetësonin standard të kishte deklaruar pasuri në proces legalizimi/posedim/pronësi etj., dhe, për këtë arsye, Komisioni iu drejtua<sup>23</sup> për të shpjeguar kronologjikisht momentin e krijimit të pasurisë, burimin e ligjshëm të krijimit, si dhe procedurën e ndjekur.

**29.2** Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se vendimmarrja i përkiste pasurisë apartament me sip. 63 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, të deklaruar në Deklaratën *Vetting* nga bashkëshorti i subjektit dhe për të nuk ishte informuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, por u vu në dijeni nga Komisioni.

**29.3** Komisioni iu drejtua ASHK-së me kërkesë për informacion mbi praktikën e vendimmarrjes për legalizim nr. \*\*\*, datë 30.12.2021, por deri në përfundim të hetimit nuk u administrua përgjigje.

**29.4** Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit në raport me faktet dhe rrethanat, i konsideron ato të plota, duke mos konstatuar problematika për verifikime të mëtejshme.

**30.** Komisioni konstatoi gjatë hetimit<sup>24</sup> se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar Kontratë Shitjeje Pasurie nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.4.2009, nëpërmjet së cilës i ka shitur shtetas E.A apartamentin e banimit me sip. 54.9 m<sup>2</sup>, me numër pasurie \*\*\*, në \*\*\*, me çmim shitjeje 3.355.000 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë. Kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit sipas Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.12.2007, në vlerën 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë.

**30.1** Nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank<sup>25</sup> rezultoi se në datën 17.4.2009 z. S.B i është kredituar shuma 3.250.000 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë me përshkrimin “Likuidim për blerje shtëpie, kati i parë pranë \*\*\*, Tiranë, nga \*\*\* sh.p.k. për S.B”. Gjithashtu, në datën 22.4.2009, nga kjo llogari z. S.B ka transferuar shumën 735.000 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë në llogarinë në emër të subjektit të rivlerësimit Anida Bica, me përshkrimin “Transfertë për mbyllje kredie”. Po nga e njëjta llogari, në datën 27.4.2009 ka transferuar shumën 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në llogarinë në emër të shtetas V.B, me përshkrimin “Pagesë për prindërit”. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare rezulton se kjo shumë ka shërbyer për mbylljen e kredisë së

<sup>22</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2024, të DP të ASHK-së.

<sup>23</sup> Shihni pyetësonin e datës 29.5.2024.

<sup>24</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2017, Aneksi 28, praktika e ILDKPKI-së.

<sup>25</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2024, të dosjes së hetimit.

disbursuar pranë kësaj banke në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë në datën 17.3.2009, në emër të shtetasës V.B. Në vijim, shtetasi S.B kryen tërheqje *cash* në shuma të ndryshme nga kjo llogari dhe në fund të vitit 2009 gjendja e kësaj llogarie është 490.087 (katërqind e nëntëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë. Kjo shumë është tërhequr në vijimësi deri në datën 8.10.2010, datë në të cilën vlera e mbetur është 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

**30.2** Komisioni vëren se situata e mësipërme i referohet periudhës 2009 – tetor 2010, periudhë në të cilën z. S.B nuk ka qenë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe znj. Anida Bica nuk ka ushtruar funksionin e ndihmëses ligjore, pavarësisht se nga veprimet bankare lidhur me shumën e përfituar nga shitja<sup>26</sup> duket se ka pasur marrëdhënie midis tyre.

**30.3** Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit mbi këtë transferim dhe kjo e fundit në pyetësinë e datës 29.5.2024 sqaroi se: *“...Në datën 20.3.2009 (periudhë përpara emërimit tim në detyrë si ndihmëse ligjore) kam marrë një kredi bankare në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë për arsye personale të blerjes së një automjeti për përdorim personal. Duke qenë se në atë kohë unë kisha filluar të njihesha me bashkëshortin tim dhe duke qenë se konsumonim kohë bashkë, ka dalë në pah edhe diskutimi i kësaj kredie personale e marrë nga ana ime për qëllimin më lart. Meqenëse ai nuk ishte dakord dhe në atë kohë kishte mundësinë për të më shlyer këtë kredi, ndërmori këtë iniciativë për pagimin e plotë të kredisë së marrë prej meje, fakt që rezultoi sipas vërtetimit bankar datë 22.4.2009, i paguar nga shtetasi S.B vlera prej 735.000 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë bashkë me interesat përkatës. Kjo vlerë u kthye prej meje pak më vonë dorazi, pasi nuk e realizova dot qëllimin e marrjes së kësaj kredie, për shkak se nuk e arrita ta blija automjetin për të cilën u mor dhe kredia bankare”.*

**30.4** Komisioni konstatoi se të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti nuk janë deklaruar në Deklaratën *Vetting* as si pasuri, as si burim krijimi për pasuri të tjera.

**30.5** Komisioni kreu analizën financiare për pasurinë e blerë nga z. S.B për vitin 2007 (kur është nënshkruar Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.) për vlerën 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë dhe me burim krijimi të ardhurat nga paga të z. S.B, nga ku rezultoi se ky i fundit ka qenë në pamundësi financiare në shumën - 1.009.646 (një milion e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekë për blerjen e kësaj pasurie.

**30.6** Në vijim të konstatimeve të Komisionit gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit me prapësimet dhe shpjegimet e saj sqaroi se:

a) Për pamundësinë financiare të z. S.B për blerjen e pasurisë: *“...Në vitin 2007, shtetasi S.B në cilësinë e blerësit ka nënshkruar Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.12.2007, në vlerën 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, me të ardhurat e krijuara prej tij dhe nga kursimet familjare të siguruara nëpërmjet prindërve të tij. Në lidhje me këtë konstatim, po ju vë në dispozicion edhe deklaratën e babait të tij, shtetasit H.B, i cili deklaron mënyrën dhe ndihmën që ai i ka dhënë djalit për blerjen e apartamentit. Prindërit e tij kanë punuar mbi 40 vjet dhe bashkë me ndihmën familjare të tyre kanë arritur t'i sigurojnë djalit të tyre rreth 500.000 (pesëqind mijë) lekë”.*

b) Për mosdeklarimin në Deklaratën *Vetting* të të ardhurave nga shitja e pasurisë: *“...Shpjegoj për Komisionin se kjo pasuri është krijuar dhe shitur në periudhën në të cilën z. S.B nuk ka qenë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe znj. Anida Bica nuk ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor. Këto të ardhura kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Vlorë, në vitin 2011, pra të ardhura të krijuara para martesës, në një kohë kur bashkëshorti im i ka disponuar me familjen e tij të origjinës, si dhe i perkasin periudhës jashtë ushtrimit të detyrës sime si ndihmëse ligjore”.*

**30.7** Trupi gjykues, pasi vlerësoi qëndrimin e subjektit së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej saj në cilësinë e provave, në raport edhe me dokumentacionin e administruar

<sup>26</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2024 – transferim shume [735.000 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë] nga llogaria e shtetasit S.B në llogarinë e shtetasës Anida Cupi, në datën 22.4.2009.

gjatë hetimit administrativ, si dhe duke pasur në konsideratë faktin se veprimet juridike për këtë pasuri janë kryer nga z. S.B përpara martesës me subjektin e rivlerësimit dhe përpara marrjes së detyrës nga kjo e fundit, çmon se kjo çështje nuk passjell ndërlikime në lidhje me pozitën e subjektit në procesin e rivlerësimit.

**31.** Komisioni konstatoi gjatë hetimit se në emër të shtetasit S.B ka rezultuar llogari bankare rrjedhëse në monedhën euro, e çelur pranë Raiffeisen Bank në datën 4.3.2010 dhe aktive deri në datën 31.5.2016, në të cilën ai ka depozituar *cash* shumën 22.000 (njëzet e dy mijë) euro, me përshkrimin “Derdh në llogari nga shitje shtëpie”, në datën 4.3.2010.

**31.1** Ka rezultuar se në këtë llogari z. S.B ka kryer tërheqje<sup>27</sup> dhe sërish depozitime<sup>28</sup> në shuma të ndryshme deri në vitin 2015.

**31.2** Komisioni kërkoi shpjegime<sup>29</sup> nga subjekti i rivlerësimit mbi këto veprime bankare të z. S.B, në vijim të të cilave ajo sqaroi se: “...Kjo shumë e depozituar *cash* 22.000 (njëzet e dy mijë) euro e ka burimin kryesisht nga të ardhurat nga shitja e shtëpisë sipas Kontratës së Shitjes së Pasurisë nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.4.2009 (llogaria në lekë është pakësuar dhe pjesa e tërhequr është depozituar në llogari në euro). Theksoj se në familjen e tyre, meqenëse ishte fëmija i madh, si fillim të gjitha pasuritë janë vendosur në një llogari të vetme si depozitë kursimi. Pikërisht nëpërmjet kësaj llogarie është paguar edhe vlera e blerjes së garsonierës në Vlorë. Referuar llogarisë bankare në lekë, periudha prill 2009 – shkurt 2010 (llogaria në të cilën është bërë pagesa për blerjen e shtëpisë nga znj. E.A), rezultojnë të tërhequra rreth 2.800.000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë deri në shkurt të vitit 2010, të cilat në mars të vitit 2010 kanë shërbyer për krijimin dhe depozitimin e shumës 22.000 (njëzet e dy mijë) euro, në llogarinë në euro në emër të z. S.B sipas përshkrimit derdhur në llogari nga shitje shtëpie. Kjo shumë është tërhequr e gjitha brenda muajit gusht 2011. Më pas nga gushti 2011 deri në vitin 2015, ka pasur lëvizje depozitim dhe tërheqje, që variojnë nga 1.000 – 2.000 (njëmijë – dy mijë) euro deri sa ajo është mbyllur”.

**31.3** Komisioni verifikoi lëvizjet në llogaritë bankare pranë Raiffeisen Bank në emër të z. S.B, nga ku rezultoi se në datën 17.4.2009 është transferuar në llogari shuma 3.250.000 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

Në datën 22.4.2009 është transferuar shuma 735.000 (shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë në llogarinë në emër të subjektit Anida Bica për mbyllje kredie, në datën 27.4.2009 shuma 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në llogarinë në emër të shtetasës V.B, me përshkrimin “Pagesë për prindërit”, si dhe në datën 22.5.2009 blerje me kartë te “\*\*\*\*” në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Nga kjo llogari janë tërhequr në vijim shuma të ndryshme *cash*, totali i të cilave deri në datën 4.3.2010 arrin në vlerën 1.265.000 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, ndërkohë që gjendja në këtë datë ka qenë 450.087 (katërqind e pesëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

**31.4** Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2010, vit në të cilin është kryer depozitimi *cash* i shumës 22.000 (njëzet e dy mijë) euro, me burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2009, nga ku rezultoi se z. S.B ka qenë në pamundësi financiare në shumën -1.788.800 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë për krijimin e likuiditeteve në vlerën 22.000 (njëzet e dy mijë) euro.

**31.5** Mbi konstatimet e Komisionit gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit me prapësimet dhe shpjegimet e saj, të shoqëruara me dokumentacion provues, sqaron se: “...Në lidhje me konstatimin e bërë për krijimin e likuiditeteve në bankë në shumën 22.000 (njëzet e dy mijë) euro, është realizuar kryesisht nga burimi i shitjes së shtëpisë me Kontratë Shitjeje Pasurie nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.4.2009 (llogaria në lekë është pakësuar dhe pjesë-pjesë e tërhequr është depozituar në llogari në euro). Kjo llogari rezulton në datën 4.3.2010 në emër të z. S.B pikërisht me përshkrimin “Derdh në llogari nga shitje shtëpie”, pasi janë të

<sup>27</sup> Për periudhën shtator 2010 – shkurt 2011 tërhiqet prej z. S.B nga llogaria shuma 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro.

<sup>28</sup> Në datën 18.5.2011, z. S.B depoziton *cash* në llogari shumën 13.600 (trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro me përshkrimin “S.B derdhje në llogari”.

<sup>29</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 29.5.2024.

ardhurat e shitjes së shtëpisë në vitin 2009 në vlerë 3.355.000 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Sikurse e kam shpjeguar edhe në pyetësin e majit 2024, theksoj se vlera prej 700.000 (shtatëqind mijë) lekësh, e marrë nga ana ime si kredi në datën 20.3.2009 (për blerje të një automjeti), është mbyllur fill pas një muaji, më 22.4.2009, pagesë kjo e kryer nga shtetasi S.B. Vlera prej 700.000 (shtatëqind mijë) lekësh e marrë kredi i është kthyer nga ana ime pasi, sikundër kam sqaruar, siç dhe rezulton nga dokumentacioni shkresor, unë nuk kam arritur të finalizoj blerjen e këtij automjeti. Gjithashtu, edhe shuma prej 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, kredi në llogarinë në emër të shtetases V.B, marrë në datën 17.3.2024, është paguar në datën 27.4.2009 nga ana e djalit të tyre S.B, dhe menjëherë kjo shumë prej 700.000 (shtatëqind mijë) lekësh i është kthyer atij nga prindërit. Marrja e kësaj kredie lidhet me qëllimin e vendosur pikërisht në atë periudhë, të shikonin për një shtëpi të vogël në plazh, por nuk arritën ta realizonin si kontribues të shtëpisë të vitit 2007. Shtetasi S.B këtë pagesë e ka kaluar më përshkrimin “Pagesë për prindërit”, pasi ata ishin kontribues për këtë apartament. Ky fakt konfirmohet edhe nga Deklarata Noteriale e datës 28.6.2024<sup>30</sup>”.

**31.6** Trupi gjykues vlerësoi qëndrimin e subjektit së bashku me dokumentacionin e paraqitur, në raport edhe me rezultatet e hetimit administrativ në tërësi dhe, nisur nga se është krijuar kjo pasuri nga z. S.B përpara martesës me subjektin e rivlerësimit dhe përpara marrjes së detyrës nga kjo e fundit, çmon se ajo nuk ndikon në procesin e rivlerësimit.

## **32. Lidhur me adresat e banimit në Deklaratën Vetting**

**32.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi të regjistruar në gjendjen civile rrugën “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*\*”, hyrja “\*\*\*\*”, kati \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, \*\*\*, Tiranë.

**32.2** Në pyetësin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se prej muajit korrik 2018 e në vijim adresa e banimit është: rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë. Kjo adresë i përket apartamentit prej 91.2 m<sup>2</sup> të përfutur nga subjekti i rivlerësimit sipas Kontratës së Shitjes së Pasurisë së Paluajtshme me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.6.2018, në vlerën 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro.

**32.3** Komisioni hetoi mbi pasurinë e përfutur nga subjekti i rivlerësimit më 27.6.2018, nga ku rezultoi se:

**32.4** Vlera e shitjes së pasurisë është 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro [10.078.400 (dhjetë milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë] dhe mënyra e pagesës është dakordësuar të paguhet në këste:

- Kësti I – 40.000 (dyzet mijë) euro, kësti i parë do të likuidohet te pala shitëse D.Sh pranë BKT-së jo më vonë se deri në datën 29.6.2018.
- Kësti II – 30.000 (tridhjetë mijë) euro do të likuidohet me kredi bankare që do t’i akordohet palës blerëse për blerjen e këtij apartamenti, likuidim i cili do i kalohet palës shitëse në llogari jo më vonë se deri në datën 30.10.2018.
- Kësti III – 10.000 (dhjetë mijë) euro do të likuidohet me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës sipas ligjit (pajisjes së palës shitëse me certifikatën e pronësisë të lirë nga çdo barrë dhe hipotekë), ku edhe kjo shumë do të likuidohet me transfertë bankare në llogarinë bankare të noteres dhe, pas pajisjes me certifikatë pronësie në emrin e palës blerëse, do t’i transferohet palës shitëse në llogari kësti i fundit.

**32.5** Në datën 28.6.2018, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, nga llogaria e shtetasit S.B është kryer transfertë bankare, duke transferuar në llogari të shtetasit D.Sh shumën 40.000 (dyzet mijë) euro me përshkrimin “Kalim kësti i parë sipas Kontratës së Shitjes së Pasurisë së Paluajtshme me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.6.2018”. Kjo shumë e ka burimin nga

<sup>30</sup> Shihni Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.6.2024, që u bashkëlidhet shpjegimeve të datës 1.7.2024 të subjektit të rivlerësimit.



shitja e pasurisë apartament sipas Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., transferuar [shuma e transferuar 45.000 (dyzet e pesë mijë)] euro në llogarinë e z. S.B nga blerësi G.S.

**32.6** Lidhur me shlyerjen e këstit të dytë të blerjes së apartamentit rezulton se sipas Kontratës së Kredisë Bankare Hipotekore nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 22.10.2018, Banka Kombëtare Tregtare në cilësinë e kredidhënësit ka nënshkruar dhënien e kredisë në shumën 3.800.000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit, me kredimarrës subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin S.B.

**32.7** Shuma 3.800.000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë është disbursuar në datën 5.12.2018, në llogarinë e kredimarrësit Anida Bica pranë kësaj banke dhe gjithashtu, po në këtë datë, është transferuar në llogari me përfitues shtetasit D.Sh dhe E.Sh, me referencë “Sa kalon në favor të D.Sh dhe E.Sh (shitësit) sipas Kontratës së Shitblerjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., për blerje apartamenti”.

**32.8** Referuar vlerës mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë për vitin 2016<sup>31</sup>, për qytetin e Tiranës, rezulton se ajo është 12.038.400 (dymbëdhjetë milionë e tridhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë [91.2 m<sup>2</sup> x 132.000 (njëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë për m<sup>2</sup>]. Sipas kursit të këmbimit të vitit 2018, pasuria rezulton në vlerën rreth 97.540 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet) euro.

**32.9** Komisioni iu drejtua ASHK-së<sup>32</sup> me kërkesë për informacion nëse pasuria (leja e legalizimit) sipas Kontratës së Shitblerjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.6.2018, është e regjistruar në regjistrin kadastral, nga ku rezultoi se ajo pasuri është regjistruar në datën 17.2.2020 dhe për të është lëshuar në emër të shtetasit D.K.Sh Certifikatë për vërtetim Pronësie nr. \*\*\* , datë 17.2.2020.

**32.10** FSHU-ja<sup>33</sup> konfirmon se me gjeneralitetet e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit S.B, në adresën rruga “\*\*\*”, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\* , referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me Kontratë Furnizimi nr. TR\*\*\*, datë 6.5.1999, në instancën Tiranë.

**32.11** Trupi gjykues vlerësoi se nuk vihen re problematika në lidhje me adresat e banimit dhe as me pasurinë e krijuar në vitin 2018.

**33.** Analiza financiare e kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar me balancë pozitive.

**34.** Nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për pasuri të tjera të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, të padeklaruar prej saj.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

**35.** Në përfundim, trupi gjykues në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht.

Problematikat që rezultuan lidhur me pasuritë e personit të lidhur (para martese dhe para detyrës) nuk ishin të tilla që mund të afektojnë subjektin e rivlerësimit. Mosdeklarimi lidhur me pasurinë apartament në Vlorë, dhuruar nga personi i lidhur familjarëve të tij (i vënë gjatë martese por para detyrës referuar subjektit të rivlerësimit), pas vlerësimit trupi gjykues çmon se nuk ka përpjekje për fshehje apo deklarim të pasaktë të qëllimshëm në kudoër të këtij procesi, e se mosdeklarimi konsiderohet një pasaktësi e paqëllimshme.

Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

<sup>31</sup> Shihni udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave.

<sup>32</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2024.

<sup>33</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2024, të Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a.

**36.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, ky institucion në datën 2.11.2017 ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Anida P. Bica, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

**37.** Komisioni i ka kërkuar institucioneve ligjzbatuese përditësim të informacionit mbi të dhëna shtesë për subjektin e rivlerësimit Anida P. Bica, për sa kohë që raporti mbi kontrollin e figurës ishte deri më 2.11.2017 dhe nga verifikimet nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

**38.** Komisioni ka kërkuar nga AKSIK-ja deklasifikimin e raportit për vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit Anida P. Bica, i cili në vijim ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar plotësisht, duke konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

**39.** Gjatë hetimit administrativ në funksion të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit Anida Bica.

#### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

**40.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

**Në përfundim,** trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Anida Bica ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**41.** Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë Gjykatës Administrative të Apelit kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar edhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**42.** Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Anida Bica është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga KLGJ-ja, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit në përshkrimin dhe analizimin e 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe rezultateve të testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

**43.** Nga përmbajtja e nëntë dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore dhe e ka relatuar për çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatës më të ulët, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e ankimit duke vepruar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 49/2012.

**44.** Në lidhje me njohuritë ligjore të zotëruara nga znj. Anida Bica, të konstatuara nga nëntë dokumentet ligjore të vlerësuara, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit, si dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura prej saj, konkludohet se subjekti i rivlerësimit në

relacionet e hartuara prej saj manifeston njohuritë e duhura ligjore për të prezantuar saktë çështjen objekt gjykimi.

**45.** Në dokumentet ligjore të analizuara evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe zbatimi i udhëzimeve të gjyqtarit relator të çështjes.

## **REZULTATET E TESTIMIT PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

**46.** Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë<sup>34</sup> pranë Komisionit rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuara në pikën 4 të nenit 179/b<sup>35</sup> të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 42<sup>36</sup> të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**47.** Në testimin profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës rezulton se ndihmësja ligjore e Gjykatës Administrative të Apelit, znj. Anida Bica, është vlerësuar në fazën e parë me 48 pikë nga 100 pikë maksimale dhe në fazën e dytë me 149 pikë nga 200 pikë maksimale, në total me 197 pikë.

**48.** Bazuar në parashikimet e nenit 165/4<sup>37</sup> të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk bën pjesë te subjektet që kanë fituar të paktën 60% të pikëve të testimit të aftësive profesionale e, për pasojë, nuk është kualifikuar për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

**49.** Duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës është në vetvete një nga kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar me një rezultat mbi mesataren në fazën e testit profesional, i cili do të shërbejë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit në mënyrë kumulative, sipas ligjit nr. 84/2016.

## **ANKESA/DENONCIME**

**50.** Nga verifikimi i regjistratit të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ankesa apo denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Anida Bica, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **Vlerësim i kriterit të aftësive profesionale**

**51.** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës së bashku me relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura shërbejnë në mënyrë kumulative për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga analiza në tërësi e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në ushtrimin e detyrës dhe është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme, duke arritur nivelin kualifikues të kërkuar nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016 në vlerësimin e aftësive profesionale.

**52.** Në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 59, pika 1, shkronja “c”, trupi gjykues e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë” në kryerjen e funksionit të ndihmësit ligjor.

<sup>34</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018.

<sup>35</sup> Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

<sup>36</sup> Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

<sup>37</sup> Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë: a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës; b) të caktohen brenda afatit 1-mujor pas përfundimit të programit të trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33, të këtij ligji, për atë sa gjejnë zbatim; c) të përfitojnë gjatë periudhës dyvjeçare të trajnimit, të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Anida Bica, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 12.7.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
Kryesuese

**Valbona SANXHAKTARI**  
Relatore

**Alma FASKAJ**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Mevi Dibra*